



RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE NË KOSOVË PËR VITIN 2018



AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË

JANAR 2019

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	3
II. METODOLOGJIA DHE INDIKATORËT	4
III. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE .	4
IV. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHPK-VE.....	6
V. KOHA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT	6
VI. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE.....	8
VII. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGJINËS	9
VIII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ	10
IX. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË.....	10
X. PËRFUNDIM.....	13

I. HYRJE

Ky raport pasqyron një përmbledhje të reformave kryesore dhe indikatorëve bazë të performancës për vitin 2018 lidhur me procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “ARBK”). Raporti si i tillë është përgatitur nga ARBK

Raporti përmban informata për një sërë indikatorësh të lidhur me performancën e ARBK-së, duke përfshirë:

- Kohën për regjistrim të shoqërive tregtare në përgjithësi në Kosovë dhe për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në veçanti, si dhe sipas komunave;
- Numrin e shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare;
- Numrin e degëve të kompanive të huaja të regjistruara sipas vendit të origjinës;
- Numrin e shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, si dhe numrin e personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë;
- Përqindjen e bizneseve individuale sipas gjinisë; dhe
- Përqindjen e ortakëve ose aksionarëve sipas gjinisë në shoqëritë tregtare në Kosovë.

Me avancimin e mëtutjeshëm të procesit të regjistrimit të shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe përpjekjet për funksionalizimin e regjistrimit të plotë elektronik, pritet që numri i indikatorëve dhe cilësia e të dhënave do të rriten dhe të pasqyrohen në raportet pasuese.

Gjatë vitit 2018, mesatarja më e ulët e ditëve për regjistrim të shoqërive tregtare ka qenë në Qershor me 1.86 ditë, ndërsa më e larta në Janar me 2.36 ditë.

Banka Botërore - Të Bërit Biznes 2019: Që nga viti 2012, Kosova është ngritur për 86 vende në Raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes. Raporti për vitin 2019 konfirmon progresin e konsiderueshëm në përmirësimin e mjedisit afarist duke rritur rangimin e Kosovës në vendin e 44-të në botë, nga gjithsej 190 shtete. Performanca e përmirësuar e Kosovës këtë vit u mbështet nga zbatimi i tre reformave rregullatore të biznesit në fushat e: lejeve të ndërtimit dhe pagesës së tatimeve. Kosova e bëri fillimin e një biznesi më të lehtë duke thjeshtësuar procesin e regjistrimit të të punësuarve si dhe duke implementuar procese për matjen e rregullt të performancës në ofrimin e shërbimeve të regjistrimit. Kosova u radhit në mesin e 13 shteteve me procesin më efikas për fillimin e një biznesi në botë.

Numri Unik dhe Regjistrimi Online: ARBK ka vazhduar bashkëpunimin me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Doganat me qëllim të funksionalizimit të plotë të sistemit të integruar për regjistrimin e shoqërive tregtare. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, në Mars të vitit 2017, ARBK në bashkëpunim me ATK-në e ka realizuar unifikimin e numrit të regjistrimit të biznesit me numrin fiskal në një numër të vetëm identifikues. Po ashtu në këtë vit ARBK ka ndërmarrë hapa që të ofrojë regjistrimin e shoqërive tregtare online. Gjatë vitit 2018, janë regjistruar online 237 shoqëri tregtare.

Platforma e Re Elektronike e regjistrimit të shoqërive tregtare është nisur në korrik të këtij viti dhe pritët të përfundojë deri në fund të vitit. ARBK pret që të fillojë me softuerin e ri për regjistrimin e shoqërive tregtare brenda muajit të parë të vitit 2019.

II. METODOLOGJIA DHE INDIKATORËT

Ky raport analizon të dhënat e nxjerra nga regjistri i shoqërive tregtare të ARBK-së. Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, procesi i regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë është akt formal, administrativ dhe informativ. Rrjedhimisht, ky raport nuk bën ndonjë supozim dhe nuk ofron shifra lidhur me shoqëritë tregtare që janë aktive dhe funksionojnë në Kosovë, mirëpo fokusohet kryesisht në matjen e efikasitetit të ARBK-së dhe qendrave komunale të regjistrimit në zhvillimin e procedurave të regjistrimit ose çregjistrimit të shoqërive tregtare.

Për të marrë një pasqyrë më të qartë të numrit, madhësisë, dhe statusit funksional të shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera ekonomike të angazhuara në veprimtari ekonomike në Kosovë, ekziston nevoja për një përpjekje më gjithëpërfshirëse duke përfshirë institucionet tjera qeveritare, në radhë të parë Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë e Administratës Publike.

Për qëllime të këtij raporti, ditët janë llogaritur në bazë të matjes së ditëve të punës. Krahasimi mes mesatareve kumulative të ditëve të vitit të kaluar (“vlera e vjetër”) me mesataret kumulative të ditëve të vitit aktual (“vlera e re”) është llogaritur duke përdorur formulën e ndryshimit në përqindje¹.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera të aplikueshme, ARBK aktualisht regjistron këto forma të shoqërive tregtare: Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, Shoqëri Aksionare, Degë e Kompanisë së Huaj dhe Kooperativë Bujqësore.

III. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE


Shoqëritë tregtare, siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, kërkohen të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosovë. Kjo pjesë e raportit matë numrin mesatar të ditëve për regjistrim të shoqërive tregtare.

Grafiku I paraqet mesataren totale të ditëve, bazuar në regjistrimin e të gjitha formave ligjore të shoqërive tregtare. Përderisa gjatë viteve të fundit ka pasur përmirësim të dukshëm në drejtim të shkurtimit të kohës për regjistrimin e shoqërive tregtare (që përfshinë të gjitha llojet e shoqërive tregtare), duhet thënë se brenda llojeve të ndryshme të shoqërive tregtare ka pasur përmirësime mjaft më të theksuara se mesatarja e pasqyruar në grafikun më poshtë. Për shembull, koha për regjistrimin e një Biznesi Individual është dukshëm më e shkurtë se koha për regjistrimin e një Shoqërie Aksionare.

Mesatarja kumulative e ditëve për regjistrimin e të gjitha shoqërive tregtare për vitin 2018 ka qenë 2.09 ditë, krahasuar me vitin 2017 ka rritje të vogël prej 1.96 ditëve. Mesatarja më e ulët e ditëve ka qenë në Qershor me 1.88 ditë, ndërsa më e larta në Shkurt me 2.43 ditë.

¹ Vlera e re (V2) - Vlera e vjetër (V1) ÷ Vlera e vjetër (V1) × 100% = Ndryshimi në përqindje


Grafiku 1: Mesatarja e ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare, 2017 - 2018:



Në Grafikon 2 paraqitet mesatarja kumulative për vitin 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018. Gjatë këtyre pesë viteve vërehet një trend në rënie, sidomos në vitin 2016 dhe 2017 ku mesatarja ka qenë më e ulët se 2 ditë, sidoqoftë në vitin 2018 ka një rritje në pak mbi 2 ditë për shkak të numrit më të lartë të shoqërive tregtare të regjistruara nga 9,335 vitin e kaluar në 9,960 në vitin 2018.

Pas analizimit të të dhënave, ARBK ka mësuar se lëndët që marrin më shumë se 30 ditë për t'u regjistruar kanë veçori që i dallojnë nga të tjerat. Për shembull, një arsye pse një lëndë do të merrte më shumë se 30 ditë është se pala që e ka paraqitur lëndën nuk e ka dorëzuar tërë dokumentacionin e kërkuar. Kjo ka shkaktuar vonesë në përfundim të lëndës pasi ARBK ka pritur palën për të dorëzuar pjesën tjetër të dokumentacionit. Rrjedhimisht, për qëllime të raportimit më të saktë, kalkulimi i mesatares kumulative të ditëve i përjashton rastet që tejkalojnë 30 ditë. Për shembull, numri i këtyre rasteve për vitin 2018 është 7, nga gjithsej 9,960 shoqëri tregtare të regjistruara.


Grafiku 2: Mesatarja e ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare, 2014 - 2018:



IV. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHPK-VE


Kjo pjesë e raportit analizon kohën për regjistrim për Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Mesatarja kumulative e ditëve për regjistrimin e SHPK-ve për vitin 2017 ka qenë 2.30 ditë, që në krahasim me vitin 2018 kur mesatarja kumulative e ditëve ka rënë në 2.44 ditë, paraqet përmirësim prej 6.08% për këtë vit.

Grafiku 3: Mesatarja e ditëve për regjistrim të SHPK-ve, 2017 - 2018:



Mesatarja kumulative e ditëve për regjistrimin e SHPK-ve në Prishtinë për vitin 2018 ka qenë 2.83 ditë, që në krahasim me vitin 2017 kur mesatarja kumulative e ditëve ka qenë 2.36 ditë, paraqet rënie të performancës prej 19.91% për këtë vit.

Grafiku 4: Mesatarja e ditëve për ta regjistruar një SHPK në qendrën e regjistrimit të shoqërive tregtare në Prishtinë, 2017 - 2018:



V. KOHA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT

Tabela I më poshtë tregon numrin mesatar të ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas qendrave komunale të regjistrimit të shoqërive tregtare për vitin 2018. Tabela e shfaqur më poshtë

përfshin 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë.

Ndarja sipas qendrave të regjistrimit në tabelë është krijuar në bazë të të dhënave të adresave së regjistruar të shoqërive tregtare. Për shembull, nëse një shoqëri tregtare e ka adresën e regjistrimit në Gjilan, është përdorur supozimi se është regjistruar në qendrën e regjistrimit në Gjilan, edhe pse ekziston mundësia që ajo shoqëri tregtare të jetë regjistruar në qendrën kryesore të ARBK-së në Prishtinë. Kjo është për arsye se ARBK aktualisht ka një sistem unik të regjistrimit të shoqërive tregtare i cili përfshinë të dhënat për shoqëritë tregtare të regjistruara në të gjithë territorin e Kosovës, pra jo sipas qendrës së regjistrimit.

Tabela 1: Mesatarja e ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas qendrave komunale të regjistrimit të shoqërive tregtare, 2018:

Qendra e Regjistrimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesatarja	Nr. i lëndëve
NovoBërdë	4.33	1.00	2.00	1.22	2.00	6.00	20.00		1.88	1.00	1.00	1.43	2.72	39
Shtërpce	2.20	2.40	1.00	1.75	1.33	1.00	5.67	24.50	3.00	1.67	2.25	2.00	3.33	39
Hani i Elezit	1.63	2.25	1.33	1.75	1.75	1.00	2.00	1.25	2.50	1.00	1.67	2.33	1.71	41
Dragash	1.75	1.50	1.00	1.17	2.00	1.25	1.00	13.20	1.00	2.00	1.75	1.33	2.46	59
Obiliq	2.00	2.43	2.20	1.33	1.38	2.13	1.70	1.50	2.38	1.33	3.00	2.29	1.93	84
Kaçanik	1.57	3.00	1.50	1.45	1.71	1.50	2.73	1.00	1.57	1.50	1.50	4.00	1.76	90
Graçanicë	10.57	3.50	1.75	2.11	2.00	1.20	1.89	1.67	2.71	2.75	1.80	3.00	2.89	96
Shtime	2.10	2.55	1.53	2.56	1.42	2.00	3.00	1.64	2.67	1.50	3.00	1.91	2.05	120
Deçan	2.41	1.70	2.00	1.88	1.25	1.25	1.50	1.83	2.00	1.29	2.50	3.50	1.57	133
Kamenicë	1.93	1.71	2.56	1.06	1.75	1.17	1.33	1.14	1.36	1.20	1.83	1.29	1.93	144
Klinë	1.53	1.60	1.67	1.17	2.00	1.92	2.13	3.63	2.07	1.53	1.33	4.36	2.01	145
Skenderaj	1.67	2.91	1.37	1.46	2.31	1.40	2.00	8.00	1.83	1.62	1.86	1.16	2.01	147
Malishevë	1.56	1.60	1.40	1.91	3.56	1.75	1.44	1.29	1.86	2.61	1.30	1.57	1.95	148
Istog	1.53	1.45	1.86	1.21	1.30	1.18	1.36	1.50	1.80	1.77	1.25	1.85	1.51	173
Glllogoc	4.30	1.77	1.50	2.42	1.73	1.29	1.27	1.00	1.33	1.61	1.30	1.60	1.93	177
Mitrovica e veriut	7.33	2.19	3.13	1.25	1.88	1.25	1.69	1.41	1.43	1.77	4.92	2.00	2.23	194
Viti	1.57	2.92	1.54	1.57	1.65	1.25	1.84	1.55	1.87	1.65	2.00	1.88	1.76	196
Rahovec	1.25	1.55	1.70	1.52	1.40	1.50	2.14	1.20	3.86	2.72	4.31	2.33	2.11	197
Lipjan	3.00	1.95	1.47	1.80	1.87	1.25	1.27	1.27	2.08	2.48	1.80	2.92	1.96	217
Suharekë	1.75	2.08	1.83	1.52	1.59	1.44	2.24	1.33	1.00	1.35	1.10	1.47	1.62	226
Vushtrri	2.50	2.03	2.05	1.48	2.03	2.21	1.90	2.29	1.96	1.88	1.56	1.66	1.94	277
Podujevë	1.58	1.53	2.00	1.40	1.33	1.55	1.38	1.30	1.32	1.42	1.85	1.20	1.44	301
Fushë Kosovë	2.81	2.92	2.18	1.86	2.14	1.95	2.12	3.23	2.62	2.20	2.05	2.28	2.36	367
Gjakovë	1.73	2.15	1.98	1.97	1.80	1.53	1.43	1.81	1.69	1.69	1.92	1.29	1.75	386
Mitrovicë	2.03	1.50	2.00	1.65	1.79	1.59	1.78	1.88	1.75	1.38	1.40	1.46	1.68	387
Pejë	1.39	1.70	1.57	1.48	1.54	1.80	1.82	1.49	1.94	1.49	1.47	1.36	1.58	540
Gjilan	2.00	2.12	1.63	1.45	1.51	1.68	1.58	1.67	1.73	1.37	1.92	2.54	1.73	556
Prizren	1.42	1.96	1.62	1.36	1.58	1.73	1.29	1.22	1.49	1.61	1.60	1.63	1.55	779
Ferizaj	2.25	2.24	1.98	1.76	1.77	1.85	2.22	1.77	2.08	1.81	1.43	1.46	1.90	845
Prishtina	2.84	3.13	2.79	2.87	2.72	2.42	2.28	2.89	3.14	2.64	2.47	2.57	2.73	2,857
Total	2.36	2.34	2.08	1.92	1.95	1.86	1.96	2.31	2.22	2.01	2.05	2.02	2.09	9,960

*Ngjyra e kuqe paraqet mesatare të lartë të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

*Ngjyra e gjelbër paraqet mesatare të ulët të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

VI. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE


Tabela 2 më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare dhe muajit të regjistrimit për vitin 2018. Nga kjo tabelë shihet se gjatë vitit 2018 numri më i madh i formës ligjore të shoqërive tregtare të regjistruar ishte Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar, pasuar nga Biznesi Individual. Ndërsa sa i përket çregjistrimit të shoqërive tregtare, prinë çregjistrimi i Bizneseve Individuale.

Tabela 2: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare, 2018:

	Muaji	Biznes individual	Ortakëri e përgjithshme	Ortakëri e kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	Kompani aksionare	Dega e kompanisë së huaj	Kooperativë bujqësore	Ndërmarrja shoqërore	Total
Shoqëri tregtare të regjistruara	Janar	360	3		473	3	2			841
	Shkurt	413	3		443	2	3			864
	Mars	335			544	1	2	2		884
	Prill	431	1	1	504	2	8			947
	Maj	492			503	3	9			1 007
	Qershor	308	3		390	3	4	1		709
	Korrik	329	1		439	2	8	1		780
	Gusht	306			370	1	6		1	684
	Shtator	406	1		380		2	1	1	791
	Tetor	404	1		525	5	3	2	1	941
	Nëntor	294			383		3			680
	Dhjetor	424			402	1	5			832
	Total	4 502	13	1	5 356	23	55	7	3	9,960
Shoqëri Tregtare të Çregjistruara	Janar	107	2		19		3			131
	Shkurt	153	3		16					172
	Mars	163	3		15		2			183
	Prill	94	5		11		4			114
	Maj	151	1		14		1			167
	Qershor	118	3		9					130
	Korrik	122	6		11	1	2			142
	Gusht	93	2		9		1			105
	Shtator	73	1		16	1				91
	Tetor	130	2	1	18		1			152
	Nëntor	93	2		16		1			112
	Dhjetor	140	1		16		2			159
	Total	1 437	31	1	170	2	17	0	0	1 658

Përderisa gjatë periudhës para vitit 2018 (2005 - 2017) forma më e regjistruar ka qenë Biznesi Individual, në vitin 2018, ashtu siç ceket më poshtë, forma më e regjistruar ishte SHPK – kjo si rezultat i thjeshtësimit të procedurave për regjistrim dhe ngritjes së vetëdijes tek bizneset.

Grafiku 5: Numri total i Bizneseve Individuale dhe SHPK-ve të regjistruara në Kosovë, 2005 - 2018:



*Kalkulimi në këtë grafik është bërë prej vitit 2004 për shkak të saktësisë së të dhënave.

VII. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGINËS

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, kompania e huaj përkufizohet si një shoqëri tregtare që është themeluar dhe aktualisht ekziston sipas një ligji të një juridiksioni jashtë Kosovës dhe e cila mund të angazhohet në aktivitete afariste në Kosovë përmes regjistrimit të një dege në Kosovë në ARBK. Tabela 3 tregon numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara në vitin 2018.

Tabela 3: Degët e kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë sipas vendit të originës, 2017 - 2018:

Shteti i originës së kompanive të huaja	Degët e kompanive të huaja 2017	Degët e kompanive të huaja 2018
Shqipëria	10	15
Zvicra	7	6
Turqia	7	10
Kroacia	2	2
Maqedonia	6	1
Zvicra		6
Italia	4	2
Serbia		3
Gjermania	3	4
SHBA	2	1
(shtetet tjera)	5	5
Total	46	55

VIII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ

Të dhënat në Tabelën 4 paraqesin numrin e shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj. Gjatë vitit 2018 janë regjistruar gjithsej 9,960 shoqëri tregtare nga të cilat 701 kanë të paktën një person të huaj fizik ose juridik si pronar, ortak ose aksionar. Nga ky numër janë përjashtuar degët e kompanive të huaja që janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 4: Numri i shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, 2017 - 2018:

Viti	Bizneset individuale	Ortakëri e përgjithshme	Ortakëri e kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	Kompani aksionare	Kooperative bujqësore	Total
2017	126	14	-	574	7	-	721
2018	105	8	1	578	9	-	701

*Këto të dhëna nuk paragjykojnë përqindjen e kapitalit të personave të huaj. Qëllimi i kësaj tabele është paraqitja e pjesëmarrjes së personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë në shoqëri tregtare në Kosovë.

*Nga ky numër janë përjashtuar degët e kompanive të huaja që janë paraqitur në Tabelën 3.


Nga 9,960 shoqëri tregtare të regjistruara gjatë kësaj periudhe në Kosovë, numri total i personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë është 937 (që nënkupton se në një shoqëri tregtare ka më shumë se një person të huaj si pronar, ortak ose aksionar).

Siç mund të shihet në Tabelën 4, forma ligjore më e regjistruar e shoqërive tregtare në mesin e personave të huaj është SHPK-ja.

IX. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË


Të dhënat në Grafikon 6 dhe 8 paraqesin pjesëmarrjen gjinore në shoqëritë tregtare të regjistruara gjatë vitit 2018. Për shkak të natyrës të formave të ndryshme ligjore të shoqërive tregtare, të dhënat më poshtë paraqiten ndaras për bizneset individuale, të cilat kanë pronar të vetëm dhe janë zakonisht biznese të vogla, dhe ndaras për format ligjore të tjera të shoqërive tregtare ku pronarët marrin pjesë si ortakë apo aksionarë.

Grafiku 6: Përqindjen e bizneseve individuale sipas gjinisë, 2018:




Edhe pse pjesëmarrja e femrave si pronare të bizneseve individuale është ende relativisht e ulët, të dhënat tregojnë një trend në rritje të pjesëmarrjes së tyre, sidomos këtë vit kur mesatarja vjetore është ngritur nga 25% në 2016 në 28% në 2017 në 30% në 2018.

Grafiku 7: Mesatarja kumulative vjetore e përqindjes së bizneseve individuale sipas gjinisë, 2017 - 2018:




Grafiku 8 tregon përqindjen e ortakëve dhe aksionarëve të shoqërive tregtare sipas gjinisë të regjistruar gjatë vitit 2018, me përjashtim të bizneseve individuale dhe degëve të kompanive të huaja.

Grafiku 8: Përqindja e ortakëve dhe aksionarëve sipas gjinisë, 2018:



Pjesëmarrja e femrave si ortakë apo aksionare është ende relativisht e ulët. Nëse krahasojmë vitin 2017 me 2018, mund të shohim se mesatarja vjetore ka mbetur e pandryshuar në këto dy vitet e fundit.



Grafiku 9: Mesatarja kumulative vjetore e përqindjes së ortakëve dhe aksionarëve sipas gjinisë, 2017 - 2018

X. PËRFUNDIM

Marrë si tërësi, Raporti pasqyron performancën e ARBK-së dhe qendrave të regjistrimit në Kosovë, në kontekstin e kohës mesatare për regjistrimin e një shoqërie tregtare. Nga këto të dhëna, shihet se trendi i mirë i performancës ka vazhduar edhe në vitin 2018. Për më tepër, ka pasur trende inkurajuese edhe për sa i përket të dhënave mbi regjistrimin sipas gjinisë, investitorëve të jashtëm, etj.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në mënyrë që të përmirësojë akoma më shumë efikasitetin e regjistrimit në ARBK ka ndërmarrë këto veprime:

- Ka iniciuar zhvillimin, institucionalizimin dhe përdorimin e rregullt të matjeve të performancës, duke nxjerrë nga të dhënat zyrtare për regjistrimin e shoqërive tregtare për ta monitoruar kohën për përpunimin e aplikacioneve për regjistrim nëpër qendrat komunale të regjistrimit dhe për të i identifikuar performuesit më të mirë si dhe ata më të përmirësuarit;
- Ka rritur fokusin në sigurimin e pajtueshmërisë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare që aktualisht është në proces të ndryshim-plotësimit;

Publikimi i raporteve të rregullta të matjes së performancës të përgatitura dhe publikuara nga ARBK shërbejnë si mjet informues për përmirësimet e mëtutjeshme të procesit.

FAKTE TË SHPEJTA LIDHUR ME REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË

Më poshtë mund të gjeni një përmbledhje të shpejtë të të dhënave të paraqitura në raportin 'Indikatorët Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për vitin 2018'.

Ky raport dhe kjo përmbledhje janë përgatitur nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Këto të dhëna paraqesin shifra të ndryshme, duke filluar nga mesatarja e ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare e deri tek numri i shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një person i huaj si pronar, ortak ose aksionar.

PËRMBLEDHJE PËR PERIUDHËN PËR SHOQËRITË TREGTARE AKTIVE 1999 - 2018

